# Co-PLAN GAZETTE

Publikim Gjashtëmujor i Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit Gazeta Nr. 8 Maj 2015




















# PO SIKUR SHQIPËRIA?

**Zhvillimet e fundit politike në Ballkan dhe Konferenca e Ballkanit mbajtur në Berlin gjatë vitit 2014, kanë risjellë në vemëndje çështje të zhvillimit dhe pozicionimit të Shqipërisë, lidhur me veten dhe me rajonin, deri diku paradoksale. Shqipëria është thuajse e padukshme në hartën e vizioneve Europiane. Megjithatë ajo synon të kthehet në një qendërsi, graviteti i të cilës varet nga integrimi – integrim brenda vetes, në Ballkan, në Europë. Vizioni Shqiptar për këtë ende nuk është shpalosur.**

Përtej integrimit dhe vizionit të munguar, paradoksi thellohet teksa Shqipëria sot rezulton të ketë vetëm 5 qytete (INSTAT – Një klasifikim i ri Urban-Rural i popullsisë së Shqipërisë, 2014), ku gjejmë Tiranën, Durrësin, Shkodrën, Elbasanin dhe Vlorën. Ky lajm është shokues, kur në fakt, kemi ndërtuar pareshtur për mbi 20 vjet në territor. PO SIKUR Shqipëria e ndryshimeve dinamike në vend të stokut e pabanuar të ndërtesave prej 302,197 (CENSUS 2011) të kishtë ndërtuar Qytete, të cilat dhe kur maten me standartet Europiane, do të mbronin statusin "qytet"?

E pra, kemi ndërtuar territorin, por në mungesë të infrastrukturave e shërbimeve publike, me fragmentimin e jashtëzakonshëm të tokës bujqësore, dhe fjetoret rreth qendrave urbane, dështojmë të klasifikojmë këto zona të reja në organizma urbane.

Në proces, kemi tjetërsuar shumë tokë bujqësore dhe natyrore, si 5,200 ha, të cilat u shfrytëzuan për ndërtime kryesisht informale nga 1990-2008 në Tiranë, apo u tjetërsuan dhe u dëmtuan në zonën e Kamzës. Pasojat e dëmtive kanë qenë varfërimi i tokës, mbishfrytëzimi i kullotave, shpyllëzimi, rritja e theksuar e erozionit, rrëshqitja e tokës, ndotja, dëmtimi i burimeve dhe trupave ujorë, etj.

Të gjitha këto sfida, nënvizojnë nevojën që Shqipëria fillimisht të përballet me disa pyetje thelbësore, përgjigjet e të cilave shpesh dhe pse shumë reformuese, apo shumë të ndryshme nga çfarë jemi mësuar, duhet të shërbejnë si baza për proceset politikë-bërëse dhe vendim-marrëse:

- PO SIKUR Të gjithë t'i paguanim taksat?
- A do të planifikojmë për një popullsi në plakje?
- A është gati Shqipëria të përballet me ndryshimet klimatike?
- Si mund të manaxhohet toka, pyjet dhe burimet ujore në mënyrë më të qendrueshme?
- Si do të mund t'i vijmë në ndihmë bujqësisë dhe të shmangim përmbytjet?
- Sa do të ndryshonte cilësia e jetesës për ne, nëse Ligji për Administrimin e Bashkëpronësisë do të zbatohej, dhe lagjeve do t'u alokohej një fond për zhvillimin e tyre?

Ky numër i Co-PLAN GAZETTE sjell në vemëndjen tuaj disa pyetje me shumë rëndësi, te cilat shpesh mbeten në plan të dytë, dhe na tërheqin vemëndjen në formën e krizave të papritura, siç janë përmbytjet, katastrofat mjedisore, etj.

Për të shmanguar reagimin pasiv, nevojiten edhe vizione të guximshme dhe skenarë afatgjatë. Skenarë të tillë duhet të studiohen sot dhe përgjigjet të planifikohen po sot, që krizat e ardhshme të mos transformohen në kriza humane, sociale dhe ekonomike, kriza territoriale dhe të qytetërimit.


Co-PLAN
UNIVERSITETI POLIS
MetroPolis Associated, Architecture & Planing sh.p.k.
Instituti për Kërkim dhe Zhvillim - IKZH_POLIS



© Kjo gazetë, përfshirë dhe imazhet nuk mund të riprodhohen, pjesërisht apo tërësisht, pa pëlqimin e autorëve dhe Co-PLAN.

# EUROPA E RAJONEVE - SHQIPËRIA E 5 QYTETEVE

Zhvillimet e fundit politike në Ballkan dhe Konferenca e Ballkanit mbajtur në Berlin gjatë vitit 2014, kanë risjellë në vemëndje çështje të zhvillimit dhe pozicionimit të Shqipërisë, lidhur me veten dhe me rajonin, deri diku paradoksale. Shqipëria është thuajse e padukshme në hartën e vizioneve Europiane. Synon të kthehet në një qendërsi, graviteti i të cilës varet nga integrimi – integrim brenda vetes, në Ballkan, në Europë. Vizioni Shqiptar për këtë ende nuk është shpalosur.

Të ardhmen dhe mirëqënien tonë ekonomike do e projektojmë mbi turizmin, bujqësinë, fuqinë energjitike dhe burimet natyrore. Mirëpo "territori" baza e zhvillimit, nuk përbën lajm, apo interes. Zhurma më e madhe vjen nga fadromat e INUK/IKMT, apo nga termi "territor" që mbizotëroi fushatën zgjedhore dhe mandatin e qeverisë aktuale.


Në fakt, lajmi më i madh lidhet sërisht me territorin: Shqipëria sot rezulton të ketë vetëm 5 qytete (INSTAT–një klasifikim i ri urban-rural i popullsisë së Shqipërisë, 2014), ku gjejmë Tiranën, Durrësin, Shkodrën, Elbasanin dhe Vlorën. Ky lajm është shokues, kur në fakt, kemi ndërtuar pareshtur për mbi 20-vjet në territor. Ritmet e rritjes së qyteteve kryesore në vend, u shoqëruan

**Por nëse kemi vetëm 5 qytete, çfarë paskemi ndërtuar deri më tani?**

me shumëfishim të sipërfaqëve të ndërtuara në masën 30-300%. Por nëse kemi vetëm 5 qytete, çfarë paskemi ndërtuar deri më tani?

E pra, kemi ndërtuar territorin, por në mungesë të infrastrukturave e shërbimeve publike, me fragmentimin e jashtëzakonshëm të tokës bujqësore dhe fjetoret rreth qendrave urbane, dështojmë të klasifikojmë këto zona të reja në organizma urbanë (sipas klasifikimeve Evropiane ). E pra, nëse vërtet duam të flasim për një Shqipëri evropiane, më parë duhet t`u përgjigjemi disa pyetjeve thelbësore:

- A mund të përputhet qasja jonë individualiste "secili për vete" me aspiratat për zhvillim e integrim?
- Projeksionet tona për zhvillim të turizmit e bujqësisë a janë realiste dhe a përputhen me territorin që trashëgojmë ne sot?
- Përse territori përbën një lajm kaq të heshtur, kur kostot janë kaq të mëdha? Në pesë vjet kemi pasur dy ligje për territorin (10119/2009 dhe 107/2014, 2014) dhe sërisht heshtje, asgjë zhvillim në territor?
- Ç'qëndron pas kësaj heshtje, thuajse të legjitimuar? Përse qytetarët nuk shqetësohen dhe pse kjo heshtje gërryen çdo ditë jetën e tyre?
- Pretendojmë të jemi konkurrues në rajon, të shfaqemi në hartë, por si? Me cilën formë zhvillimi?




Burimi: INSTAT–një klasifikim i ri urban-rural i popullsisë së Shqipërisë, 2014

# PO SIKUR TË (MOS) PLANIFIKOJMË PËR POPULLSI NË PLAKJE?

**Me 1 në 8 persona, mbi 65 vjeç , ritmi i plakjes së popullsisë Shqiptare ka qenë më i larti në kontinentin Europian , gjatë dekadës së fundit. Me moshë mesatare 35 vjeç, Shqipëria është ende një nga vendet me popullsi të re, krahas Irlandës, Islandës e Turqisë. Por, që prej 2001, grupmosha 0-15 vjeç ka rënë me 41%. Arsyet përfshijnë: lindshmëri në rënie dhe në moshë më të vonë, pra tkurrje e madhësisë mesatare të familjes në masën 9.3% ; emigracion; etj.**

E kundërt është tendenca për grupmoshën 65 vjeç e lart, sepse jetëgjatësia rritet. Nga viti 1950 njerëzit jetojnë mesatarisht rreth 22 vjet më shumë . Gjenerata *Baby Boom* e viteve '45-'90të, gjithashtu ndikon me rritje të shpejtë të numrit të të moshuarve, ndërsa lindjet bien. Projeksionet për plakjen e popullsisë janë në rritje për 20 vitet e ardhshme . Një pjesë e konsiderueshme e kësaj grupmoshe në Shqipëri, në pamundësi të lëvizjes jeton në zonat rurale në depresion e me mungesa të shërbimeve specifike.

Mos vallë sapo jemi përballur me atë dukuri që Europa e përjeton prej dekadash – ndryshim i ekuilibrave demografikë në favor të moshës së tretë? Qytetet ndërtohen nga njerëzit, për njerëzit dhe transformohen sipas nevojave moshore. Nëse planifikuesit dinë se ku përqendrohen grupmoshat dhe vendimmarrësit "lejojnë" pjesëmarrje demokratike në planifikim, hapësirat e jetueshme do të formëzohen me shërbime shëndetësore, infrastruktura sociale, hapësira publike, teknologji transporti urban, etj. për çdo moshë dhe individ.

Hapësira dhe transporti publik, si dhe sinjalistika e trafikut sipas parimeve të dizajnit universal duhet ende të krijohen në Shqipëri. Strategjitë dhe ofertat e strehimit me kosto të lehtësuara, apo pa kosto; rregulloret urbane me përdorime toke me lehtësira për moshën e tretë; ofrimi i gamës së plotë të shërbime sociale për moshën e tretë, etj. janë disa nga elementet kyçe që planet dhe buxhetet e bashkive dhe institucioneve publike/private duhet të garantojnë. Kujdes, çdo strategji e vizion territorial/social për moshën e tretë, sikurse për çdo moshë, nuk duhet të promovojë e as të shkaktojë ndarje dhe veçim. Vendbanimet urbane e rurale duhet të inkurajojnë përzierjen moshore, ndërsa garantojnë lehtësira fizike për çdo përdorues. Hapësira universalisht ergonomike, duhet të jetë parim dhe rezultat i çdo procesi qytet [trans] formues.




## KOEFIÇIENTI I VARËSISË 47%

Kjo është një dritare mundësish ekonomike që do të zgjasë deri në 2021. Nëse Shqipëria do të përfitojë plotësisht nga ky dividend demografik do të varet sesa e arsimuar, e aftë dhe e shëndetshme mjaftueshëm do të jetë fuqia punëtore dhe nëse politika të duhura social ekonomike do të vendosen për punësimin e këtyre njerëzve në punë produktive.

Burimi: INSTAT–Shqipëri Popullsia dhe Dinamikat e Saj - Horizonte të Reja Demografike?, 2014
Përgatiti: Co-PLAN



**1.05 milionë**

**1989**

**Numri i fëmijëve nën moshën 15 vjeç në Shqipëri shënonte 1,05 milion.**



**0,538 milionë**



**2014**

**Numri i fëmijëve nën moshën 15 vjeç në Shqipëri shënonte 537,928.**


# PO SIKUR Shqipëria, edhe pse jo Kontribuese, të jetë Pësuese e Efekteve të NDRYSHIMEVE KLIMATIKE?

**Shkarkimi i gazrave serrë për frymë në Shqipëri është ende i ulët krahasur me vendet e industrializuara. Për shembull emetimet e gazeve serrë per capita ishin 2.47 ton CO2 eq per capita ton, pra 4-5 herë më të ulëta se sa mesatarja e këtyre vendeve në vitin 2000. Këto shifra tregojnë që Shqipëria ka një kontribut pothuajse minimal në shkarkimin e gazeve serrë, përgjegjëse për ndryshimet klimatike. Kjo tingëllon lehtësuese, sikurse tregon për një zhvillim ekonomik, i cili nuk është orientuar drejt veprimtarisë së industrive të rënda apo të mëdha. Këto të fundit rritin ndjeshëm PBB-në e një vendi dhe kanë nivelet më të larta të shkarkimeve në ajër. Mirëpo, nga ana tjetër fenomenet klimatike të viteve të fundit në Shqipëri tregojnë se ne po pësojmë të njëjta efekte si edhe vendet që aktualisht po kontribuojnë për to.**

Në vitin 2050 Shqipëria, sikurse dhe vendet e tjera në botë, pritet që të përballet me disa ndryshime klimatike: i) rritje të temperaturave mesatare vjetore me rreth 2°C; ii) ulje të sasisë së reshjeve mesatare në vit me 8%; iii) rënie me 28% të burimeve ujore vjetore për drithërat; iv) rritje të indeksit të kohëzgjatjes së valës së të Nxehtit me 20 ditë; v) rritje të përgjithshme të numrit të njëpasnjëshëm të ditëve të thata dhe një ulje të numrit të ditëve të acarta; vi) rritje të ekspozimit ndaj insekteve të reja të dëmshme për drithërat bujqësore dhe blegtorinë .

Një nga sektorët më të prekur nga këto ndryshimet klimatike është dhe do të jetë sektori i bujqësisë, që për Shqipërinë do të thotë: 58% e popullsisë aktuale të vendit (e punësuar në këtë sektor) dhe 21% e GDP-së mesatare të vendit. Krahasuar me konteksin më të gjerë europian, vetëm 4.5% e popullsisë të këtyre vendeve është e punësuar në sektorin e bujqësisë dhe ai sjell një përfitim prej 2% të GDP-së mesatare të vendeve .

**Rënie ekstreme të rreshjeve dhe rritja e nivelit të lumenjve do t'i bëjnë përmbytjet më të rënda. Në 2100, pritet një rritje e nivelit të detit deri në masën 30-45cm, duke përmbytur kështu tërësisht zonën bregdetare.**




Burimi: Flood Fire-Tree Website. Përpunuar nga Universiteti POLIS "Albania Manifesto 2030".

Shqipëria është anëtarësuar në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK), në Janar 1995 dhe në Protokollin e Kiotos, Janar 2005. Si një vend që nuk bën pjesë në Aneksin I të KKKBNK-së, Shqipëria nuk ka detyrime të përcaktuara për të reduktuar shkarkimet e gazeve serrë. Si palë në KKKBNK, i ka përmbushur detyrimet, nëpërmjet hartimit të Komunikimeve Kombëtare (2002, 2009, dhe është në proces hartimi i Komunikimit të Tretë Kombëtar, që parashikohet të finalizohet gjatë vitit 2015).

Pavarësisht "pafajësisë" sonë, si vend kemi nisur tashmë të përballemi me efektet e ngrohjes globale dhe të ndryshimeve klimatike. Nuk mund të mbyllim sytë përballë këtij fakti me argumentin se nuk kontribuojmë ose kontribuojmë shumë pak në arsyen e problemit. Vetëm në pesë vitet e fundit kemi qenë

Burimi: Faqja www.press-greece.gr Aksesuar në muajin Maj 2015.



dëshmitarë të përmbytjeve masive në veri, ku numërohen 7563 familje dhe subjekte tregtare në Qarkun Shkodër të prekura nga përmbytjet ; të thatësirave të shpeshta e të gjata në kohë me ndikim në dëmtimin e kulturave bujqësore në jugperëndim të vendit;, të erozionit detar që në pjesë të caktuara të vendit (Ishull Lezhë, bregdeti i Semanit etj) ka "përpirë" mbi 20 metra brez detar në 10 vjet; të ndotjes së lartë të ajrit në zonat e populluara urbane (vlerat e ndotësve PM10 33.5µg/m3 dhe ato të NO2 41,6µg/m3 etj. Sipas studimeve dhe skenarëve të IPCC-së , nëse kontributet botërore në ngrohjen globale vazhdojnë me të njëjtat ritme, deri në vitin 2050, niveli i detit mund të rritet me rreth 30-40 metra në brigjet Shqiptare. E përkthyer në fakte territoriale, kjo nënkupton fshirjen e brigjeve aktuale dhe përmbytjen fatale të disa vendbanimeve, përfshirë periferitë e disa qyteteve të rëndësishme.

Nëse skenarë të tillë negativë ndodhin realisht, Shqipëria duhet të jetë e përgatitur. Përgjithësisht, e vetmja mënyrë konkrete se si qeveritë janë përballur disi me efektet e ndryshimeve klimatike ka qenë ajo përmes fondeve për emergjencat civile, të cilat në vite kanë pasur vlera nga 6 000 000 Euro deri në dyfishin e kësaj shume . Në disa raste kjo vlerë ka përfaqësuar vetëm shpenzime operative dhe në raste të tjera, rreth gjysma e saj është dedikuar për investime kapitale, kryesisht në sistemin e kullimit, të vaditjes dhe të mbrojtjes së tokës (hidrovore etj.). Ky kapacitet i kufizuar ndërhyrës dëshmon për nivelin e ulët të përgatitjes së vendit për ndryshime të tejskajshme.


Ende nuk është pranuar realisht (por, pranohet teorikisht) që përballimi i përmbytjeve dhe i emergjencave të tjera si këto (edhe ato prej ndryshimeve klimatike) nuk mund të kryhet vetëm përmes ndërhyrjeve post-factum, pra përballimi i emergjencës dhe i riskut për humbje në njerëz dhe kafshë. Emergjenca duhet të paraprihet që ajo të mos shtrijë efektet në popullsi dhe territor ose së paku t'i ketë të kufizuara. Për këtë nevojitet planifikim paraprak, dhe hartimi i planeve të territorit është momenti më i mirë për të analizuar burimet e rrezikut, efektet e mundshme dhe masat parandaluese ose zbutëse.

Nevojiten edhe vizione të guximshme e afatgjata. Mundet që në 30 vitet e ardhshme të ndodhemi para faktit se qytetet bregdetare duhet të evakuohen dhe popullsia të lëvizë në brendësi të vendit. Këto familje do të kenë nevojë për strehim dhe punësim. Do të duhet të vendosen në qytete të reja apo të zgjerohen ato ekzistuese, ndërsa burimet lokale duhet të kënaqin nevojat për punësim dhe ekonomi. Skenarë të tillë duhet të studiohen sot dhe përgjigjet të planifikohen po sot, në mënyrë që krizat e ardhshme klimatike të mos transformohen në kriza humane, sociale dhe ekonomike, kriza territoriale dhe të qytetërimit.

# PO SIKUR TË SILLEMI SIÇ DUHET ME TOKËN?

**Toka përbën themelet mbi të cilën ndërtojmë jetën tonë. Në të ndërtohen shtëpitë, rrugët, kryejmë aktivitetet tona të përditshme si dhe shërben si strehë për çdo gjallesë. Me format e pafundme të relievit, toka krijon kushte fizike për një larmishmëri llojesh bimore e shtazore, në funksion të një biodiversiteti të pasur dhe një sërë funksionesh ekologjike. Toka rregullon ciklin e ujit dhe e filtron atë përpara se të arrijë në pellgun nëntokësor. Toka ofron ushqyesit për bimët duke garantuar qëndrueshmërinë e cikleve të azotit, karbonit, fosforit etj. Në këtë mënyrë, ciklet natyrore dhe zinxhirët ushqimorë sigurojnë qëndrueshmërinë e jetës në planet.**

Burimi: Co-PLAN.




Në Shqipëri, rëndësia e tokës nuk përkon me rëndësinë që ka manaxhimi i saj, edhe pse sipërfaqja është e vogël (28,748 km2). Veçanërisht gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit, për arsye politike, ekonomike apo sociale, toka ose është keqmanaxhuar (ndërtime në zona të papërshtatshme, përqëndrimi i industrisë në zona bujqësore, hedhja e mbeturinave pa kriter, shpyllëzim, etj.) ose ka degraduar (për shkak të varfërimit të saj, keqpërdorimit, ndotjes, etj.) e si pasojë është braktisur (sidomos tokat jo shumë cilësore, të ndotura, ose në zona të largëta).

Për shembull, vetëm në Tiranë, u humbën mbi 3,000 ha tokë bujqësore dhe natyrore nga viti 1990 deri në 2008 si rezultat i ndërtimeve (kryesisht informale) në shtim, ndërsa mbi 2,200 ha tokë bujqësore është tjetërsuar ose dëmtuar në Kamëz . Në çdo rast, pasojat kanë qenë varfërimi i tokës (në 10.2% të territorit) mbishfrytëzimi i kullotave (në 42.4%), shpyllëzimi (17.4%), rritja e theksuar e erozionit (12.5%), rrëshqitja e tokës (në rreth 150 ha), kripëzimi (2.3%) dhe ndotja (0.6%) . Një problem tejet i theksuar është ndotja e ujërave sipërfaqësore e nëntokësore (p.sh. në Gjanicë, Erzen, Shkumbin etj) nga mbetjet. Vetëm në zonat urbane depozitohen rreth 852,360 ton mbetje në vit ose 2,335 ton në ditë të pandara sipas llojit, në mungesë të një landfilli inxhinierik e sanitar. Përgjithësisht përgjatë lumenjve apo në lugina, në të cilat ujërat nëntokësorë lidhen drejtpërdrejt me sipërfaqen. Nëse kuptojmë vlerën e vërtetë të tokës dhe ndryshojmë praktikën e manaxhimit të saj, krijimi i mundësive për zhvillim ekonomik do të jetë i menjëhershëm. Vetëm ish-ferma bujqësore e Lushnjes, nëse toka mirëmbahet, ka aftësi të prodhojë atë produkt bujqësor që jep aktualisht e gjithë Shqipëria.

Ndaj investimet në bujqësi, veçanarisht në rindërtimin e një sistemi vaditës dhe kullimi duhet të ketë përparësi, për t`i rikthyer tokën fermerit dhe produktin bujqësor vendas konsumatorit (nga 423,000 ha vetëm 180,000 kanë ujitje) . Një sistem i mirë vaditës do të shmangte edhe shfrytëzimin e ujit nëntokësor që përdoret nga fermerët për ujitje në mungesë të këtij sistemi dhe mbi të gjitha ndotjen e tij. Mirëmbajtja e sistemit duhet të kryhet si nga institucionet, edhe nga pronarët e tokave.

Manaxhimi i qëndrueshëm i tokës dhe pyjeve do të: shpëtojë 30% të tokës bujqësore nga erozioni, i cili çon në humbjen e një sasie dheu të barabartë me 20-70 ton për hektar në vit; mundësojë çlirimin e 1,534,533,000 ton O2 në vit; Në ofrimin e një mundësie për sekuestrimin e CO2 në qytetet tona të dendura që në pika ekstreme i kalon x% vlerat kufi të BE-së . Nëse Shqipëria investon në bujqësin organike, sasia e plehrave kimike, sidomos me bazë N dhe P , që përfundojnë sot në lumenj dhe delta në bregdet, mund të ulet. Vetëm lumenjtë sot transportojnë në det rreth 162,000 ton pleh kimik . Kjo krijon kushtet për shmangjen e eutrofikimit të trupave ujore të mbyllur si: lagunat e liqenet. Do të ketë ndikim pozitiv jo vetëm në biodiversitet, por në synimin e rritjes së kontributit të turizmit ne PBB aktuale, si një sektor motor i zhvillimit të ardhshëm ekonomik në Shqipëri. Mbi të gjitha, nëse do të mund të rrisnim ndjeshmërinë e qytetarve ndaj mjedisit, burimeve natyrore apo cilësisë së qyteteve që pretendojmë të kemi, do të krijonim një ndjenjë qytetarie të domosdoshme për një zhvillim të qëndrueshëm të vendit.

Burimi: www.truckingjakarta.com Aksesuar në Maj 2015. Përpunuar nga Co-PLAN.



# 90 KONTEINERË SI KY ME MBETJE NË DITË

## 852,360 TON MBETJE NË VIT

**2,335 ton/ditë mbetje të pandara sipas llojit dhe pa kushte të landfilli inxhinierik e sanitar, shpesh pranë lumenjve dhe luginave, në të cilat ujërat nëntokësorë lidhen drejtpërdrejt me sipërfaqen.**

# PO SIKUR TË [MOS]MANAXHONIM PYJET?

Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2015 - Berat. Përpunuar nga Co-PLAN.



**Sipërfaqja e mbuluar me pyje në territorin e Shqipërisë përbën 52% (1.5 Mha ose e shprehur ndyshe 0.5 ha/banor ) të sipërfaqes totale (2.9 Mha) të vendit, ku 30% përbëhet nga pyje të larta, 42% (0.4 ha/banor) nga korijet dhe 28% (0.29 ha/banor) nga shkurret. Programet e realizuara deri më sot në sektorin e pyjeve kanë mundësuar transferimin e 60% të sipërfaqes së pyjeve dhe të kullotave në 317 njësi të qeverisjes vendore (sipas hartës administrative para Qershorit 2015) për të siguruar gjithëpërfshirjen, afërsinë e burimit me institucionin qeverisës dhe mbështetjen me plane menaxhimi, punime pyllëzimi e përmirësimin në pyje. Sipërfaqja e fondit pyjor kullosor e mbuluar me plane mbarështimi deri në vitin 2012, është rritur me 48% krahasuar me vitin 2007 nga pynimet pyjore të kryera në 12 000 ha pyje të degraduara, erozioni është reduktuar me 200,000 ton .**

Ndonëse niveli i prerjeve të paligjshme është ulur me 55% (2010-2013), sipërfaqe të konsiderueshme të pyjeve aluvionale bregdetare eleminohen çdo vit nga erozioni detar aktiv (50 000 ha territore të tilla në të gjithë rivierën e vendit dhe zonat turistike). Ndonëse vazhdohen të raportohen prerje të paligjshme, nëse do të shikojmë shifra e vitit 2010 (11.25 m3/ha/vit humbje tokë) me ato të vitit 2013 (5.3 m3/ha/vit humbje toke) mund të themi që ka patur një përmirësim.

Procesi i transferimit të sipërfaqeve të pyjeve dhe kullotave nën administrimin e njësive vendore është ende i papërfunduar (vetëm 84% e njësive vendore - 317 njësi vendore e kanë përfunduar këtë process). Ajo pjesë e pyjeve, e cila ende nuk ka një status menaxhimi të caktuar, apo që ndodhet në zona shumë të largëta malore, bëhet shpesh pre e prerjeve masive të paligjshme. Nga ana tjetër, ka jo pak raste kur sipërfaqet pyjore, aktualisht nën kompetencën e autoriteteve vendore, nuk administrohen si duhet dhe rezultojnë në to prerje të paligjshme, tjetërsim të përdorimit të tokës, humbje të mundësive për më shumë të ardhura vendore, dëmtim të shërbimeve ekologjike të pyjeve, erozion, tjetërsim të shtretërve të lumenjve, rrëshqitje të tokës në zona të banuara etj.

Nëse menaxhojmë mirë pyjet, shmangim kufizimet dhe rezultatet negative të krijuara deri më sot nga mungesa e administrimit, apo keqadministrimi. Mirëpo, a janë në gjendje autoritetet vendore që të administrojnë pyjet në mënyrë të integruar, duke kontribuar në mbarështimin e tyre dhe në përthithjen e fitimeve që krijon ky byrim natyror? Mendohet se me reformën territoriale, kapacitetet teknike dhe menaxhuese për pyjet do të shtohen. Por, edhe sipërfaqet pyjore në përgjegjësi të bashkive do të rriten.

Bashkitë do të jenë përgjegjëse edhe për zhvillimin rural. Ato bashkë me institucionet kombëtare do të jenë të interesuara për të rritur gamën e shërbimeve ekologjike dhe ekonomike që mund të marrim nga pyjet, në funksion të komuniteteve lokale e të përdoruesve. Pyjet do të përdoren njëkohësisht për të ofruar lëndë drusore dhe ushqyese, aktivitete rikrijuese dhe turizëm, produkte të veçanta me vlerë në mjekësi dhe kulinari, për të strehuar biodiversitetin dhe speciet e veçanta, për të pastruar ajrin, për të rritur qëndrueshmërinë e

**Paaftësia apo pamundësia për të mirëmanaxhuar sektorin pyjor, ka patur pasoja të rënda mjedisore dhe ekonomike nw territor. Ky dëm i pallogaritshëm në kohë ka nxjerrë në pah nevojën për krijimin e një sistemi te qëndrueshëm për menaxhimin e pyjeve .**



sipërfaqeve të pjerrëta etj.


Në këto procese duhet të garantohet qëndrueshmëria e sistemit (e pyllit si burim natyror), dhe ende mbetet për t`u provuar suksesi i decentralizimit në këtë drejtim. Për më tepër, pyjet janë pasuri e përbashkët e si të tilla, qasja ndaj tyre është e pakufizuar, ndërkohë që burimi është i shterueshëm. Për këtë arsye, pyjet mund të menaxhohen me sukses vetëm përmes skemave institucionale ku, veç bashkive e Min-





Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2015 - Foto lart Baldushk, Foto majtas Berat.
Përpunuar nga Co-PLAN.

# PO SIKUR t'i Merrnim Seriozisht Sistemet




Burimi: Fotografia nga siti www.dmouth.com aksesuar në Maj 2015. Të dhënat për grafikët nga Buxhetet e Shtetit sipas vitete përkatëse. Grafikët të përgatitur nga Co-PLAN.

Ndonëse reshjet mesatare të vendit janë të bollshme për të përmbushur kërkesat e sektorit të bujqësisë për ujitje, gjatë stinës së verës bie vetëm 20% e sasisë së tyre. Nën efektet e ngrohjes globale, sasia e reshjeve dhe shpërndarja e tyre gjatë vitit është çoroditur edhe më tepër. Gjatë dekadës së fundit, nga vëzhgimet e kryera tregohet qartë që niveli i rreshjeve në formë dëbore ka rënë dhe janë shtuar rreshjet e rrëmbyeshme me interval të shkurtra. Nga një vëzhgim i kryer për qytetin e Tiranës për një periudhë 10-vjeçare, tregohet se niveli i rreshjeve është ulur ndjeshëm gjatë muajve të verës, deri në vetëm 4 ditë me shi me një sasi 8 mmm në Korrik dhe 4.2 mm në Gusht .

Një shpërndarje vjetore jo e balancuar rezulton në mungesa ujore për vaditje të kulturave bujqësore gjatë verës dhe mbingopje të tokës me ujë (deri në përmbytje) gjatë dimrit. Duke ditur se disa nga tokat bujqësore më cilësore (e më të mëdha) në Shqipëri janë krijuar përmes bonifikimit të kënetave, rreziku nga përmbytjet është edhe më i lartë, nëse sistemi i kullimit nuk funksionon sikurse është planifikuar.

Nga viti 1990 sipërfaqja e cila ishte e pajisur me sistem vaditje ishte rreth 90,000 ha dhe nuk ka ndryshuar në këto 25 vitet e fundit. Një pjesë e këtij sistemi raportohet të jetë e dëmtuar/amortizuar, ku ndër faktorët kryesorë janë sa mungesa e mirëmbajtjes, aq edhe ndërhyrjet me ndërtime informale mbi sistem dhe bllokimet e tij nga depozitime të paligjshme të mbeturinave të ngurta dhe të ujërave të zeza. Kështu, rreziku nga përmbytjet bëhet edhe më domethënës. Nevojat optimale për ujitje dhe kullim në të gjithë territorin e vendit duhet të jenë 3,000-5,000 m3/ha, ose mesatarisht me një hidromodul prej 4-5 litra/sek/ha. Infrastruktura për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet është e projektuar për ujitjen e rreth 420,0 ha tokë bujqësore (potencialisht të ujitëshme 360,000 ha), garantimin e kullimit nw 280,000 ha tokë00 .

Përmbytjet e 5 viteve të fundit, (si në veri, dhe në jug), dëshmojnë (midis të tjerash) edhe për mungesë të vazhdueshme të mirëmbajtjes dhe/ose manaxhimit të sistemeve të kullim-vaditjes në pjesën më të madhe të tokave bujqësore të Ultësirës Perëndimore. Mijëra hektarë tokë bujqësore, blegtorale e shtëpi banimi në zonat rurale u gjendën papritur nën ujë gjatë këtij viti (2015), si dhe në 2010 14,100 ha tokë të Qarkut të Shkodrës u përmbytën (rreth 7563 familje dhe subjekte tregtare pësuan dëme të konsiderueshme si materiale, bujqësore dhe blegtorale).

Nëse vëmendja e autoriteteve dhe përdoruesve do të përqendrohej seriozisht

# e Kullimit dhe Vaditjes në Bujqësi?



Burimi: Arkivi Co-PLAN, 2015 - Kuçovë.

në administrimin e sistemit të kullimit dhe vaditjes, rezultati do të ishte i dukshëm gjatë dimrit dhe në tregjet me prodhime vendase. Mijëra hektarë tokë bujqësore dhe qindra shtëpi do t`i shmangeshin përmbytjes, ndërsa ekonomitë fshatare nuk do të merrnin goditje marramendëse.

Por modernizimi dhe mirëmanaxhimi i sistemeve të kullimit dhe vaditjes kërkon ndërhyrje të thella strukturore. Në 5 vitet e fundit (2011-2015) investimet kapitale për infrastrukturën e kullimit dhe vaditjes kanë qenë vetëm 1-4% e shpenzimeve kapitale në nivel vendi për të gjitha institucionet buxhetore. Në rastin e infrastrukturës rrugore këto % janë rreth 10-15 herë më të larta ndërsa për ujësjellës kanalizimet rreth 5 herë më të larta. Shpenzimet korrente (pra që lidhen edhe me mirëmbajtjen) për kullimin dhe vaditjen përbëjnë 30-50% të totalit të ministrisë përkatëse për këtë sistem dhe kanë vlera absolute jo më të mëdha se 7,000,000 Euro/vit . Pra, sistemi i kullimit dhe i vaditjes duhet ende të kthehet në një prioritet real për qeverinë. Vlerat e ulëta në financime nuk ndihmojnë aspak që sistemi (së paku niveli kryesor në rrjet) të operojë cilësisht dhe në funksion të zhvillimit të bujqësisë.

Mirëpo, nisur nga sa më lartë, interesi i qeverisjes për sistemin e kullimit dhe vaditjes lidhet me faktorët e mëposhtëm:

1. Ky sistem i shërben tokës bujqësore dhe cilësia e tij ndikon në prodhimin bujqësor. Por, në të njëjtën kohë, fragmentimi i lartë i tokës bujqësore, ul efiçencën dhe rendimentin e saj, si rezultat edhe sasinë e produktit bujqësor vendas dhe më tej interesin për të investuar në sistemin e kullimit dhe vaditjes si një sistem mbështetës.
2. Politikën që qeveria dhe bashkitë do të ndjekin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me tokën bujqësore. Ndërtimet informale dhe fragmentuese në tokë bujqësore deri më sot dhe kërkesat familjare për zgjerimin e tyre, nuk mund të marrin një përgjigje vetëm nga këndvështrimi i planifikimit, por në kombinim më politikën sektoriale të bujqësisë dhe të ujërave.
3. Sistemi i kullimit dhe vaditjes është pronë e përbashkët. Aksesohet nga çdo bujk; keq/mbipërdorimi i tij nga një individ i vetëm ndikon në mundësinë e përdorimit tek mijëra të tjerë; përgjegjësia për të ndahet mes qeverisë qendrore, bashkisë dhe fermerëve që kanë akses në të. Pra çdo mekanizëm institucional për menaxhimin e tij, rezulton të jetë "shumë-shtresash" (*multi-layers*) dhe tejet kompleks.

**Buxheti sipas ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore[1] (në mijë lekë)**

| Viti | Zëri në buxhet | Totali i Shpenzimeve Korrente | Totali i Shpenzimeve Kapitale | Totali i Shpenzimeve Buxhetore | Raporti Kapitale/ Total |
|---|---|---|---|---|---|
| 2015 | **Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave** | 5,003,810 | 3,410,610 | 8,414,420 | 41% |
| | Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes | 887,000 | 2,035,000 | 2,922,000 | 70% |
| | **Totali** | **209,941,250** | **66,999,582** | **276,940,832** | **24%** |
| 2014 | **Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit te Ujrave** | 4,614,610 | 3,284,844 | 7,899,454 | 42% |
| | Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes | 873,800 | 1,225,000 | 2,098,800 | 58% |
| | **Totali** | **198,667,157** | **66,459,500** | **265,126,657** | **25%** |
| 2013 | **Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit** | 3,880,000 | 2,895,480 | 6,775,480 | 43% |
| | Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes | 860,000 | 869,400 | 1,729,400 | 50% |
| | **Totali** | **188,024,467** | **70,104,889** | **258,129,356** | **27%** |
| 2012 | **Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit** | 3,952,869 | 2,828,424 | 6,781,293 | 42% |
| | Menaxhimi i infrastrukturës se kullimit dhe ujitjes | 827,776 | 1,303,800 | 2,131,576 | 61% |
| | **Totali** | **179,342,325** | **69,871,813** | **249,214,138** | **28%** |
| 2011 | **Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit** | 4,006,800 | 3,954,988 | 7,961,788 | 50% |
| | Menaxhimi i infrastrukturës se kullimit dhe ujitjes | 737,550 | 3,023,075 | 3,760,625 | 80% |
| | **Totali** | **178,902,430** | **82,502,000** | **261,404,430** | **32%** |

Burimi: Ligjet e Buxhetit të Shtetit për vitet 2011-2015. Përpunuar nga Co-PLAN.

1. Ligji nr. 10335, datë 2.12.2010 "Për Buxhetin e Shtetit të Vitit 2011".
2. Ligji nr. 10487, datë 12.05.2011 "Për Buxhetin e Vitit 2012", i ndryshuar.
3. Ligj nr. 119/2012, datë 17.12.2012 "Për Buxhetin e Vitit 2013".
4. Ligj nr. 185/2013, datë 2.12.2013 "Për Buxhetin e Vitit 2014".
5. Ligji nr. 160/2014 , datë 27.11.2014 "Për Buxhetin e Vitit 2015".

Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2015 - Kuçovë.





Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2015 - Zona e ish-Kënetës (Durrësi i Ri).

# PO SIKUR Burimet Ujore në Shqipëri të Manaxhoheshin në Mënyrë të INTEGRUAR?

**Manaxhimi i integruar i burimeve ujore do të thotë se burimet ujore janë një pjesë përbërëse e ekosistemit, një burim natyror dhe një e mirë sociale dhe ekonomike. Kjo i jep përkujdesjes për burimin ujor, avantazh ndaj shfrytëzimit të tij. Një sjellje e tillë na ndihmon të fuqizojmë aftësinë për të qenë "resilient" – mbijetues, të adaptueshëm, vetëripërtëritës**

**Uji është jetë. Rreth 70% e trupit tonë përbëhet nga uji . Për fat të keq, 97.5% e ujit ndodhet në oqeane dhe vetëm 2.5% e tij të mund të përdoret si ujë i pijshëm (përjashto rastin e shkripëzimit, e cila është ende një praktikë e kushtueshme). Mbrojtja e burimeve ujore në Shqipëri, si kudo në botë, do të thotë garantim i mbijetesës, përshtatjes dhe jetëgjatësisë.**





Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2015 - (Lart) Berat, (Poshtë) Kuçovë.

Edhe pse rreth 70% e tokës është mbuluar me ujë , menaxhimi i përshtatshëm i burimeve ujore në vite në nivel botëror, ende nuk e ka marrë në konsideratë këtë fakt. Për një kohë të gjatë, burimet ujore janë menaxhuar në nivel sektorial, dhe kjo mënyrë vazhdon të ekzistojë në një pjesë të mirë të vendeve, përfshirë Shqipërinë. Edhe pse që prej vitit 2012, Shqipëria ka një ligj për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, parimet dhe praktikat e tij ende nuk janë reflektuar në mentalitetin dhe rutinën e institucioneve publike e private në lidhje me përdorimin e ujit.

Uji është i nevojshëm për furnizimin e popullsisë me ujë të pijshëm, për bujqësinë dhe industrinë, për sektorin energjitik etj. Në këtë këndvështrim është shfrytëzuar, por, nuk është menduar për ndikimin që ky shfrytëzim mund të ketë në kohë në vetë qëndrueshmërinë e sistemit apo burimit ujor dhe në shërbimet ekologjike që ai ofron.

Si rrjedhojë, shumë burime ujore janë dëmtuar. Ndotja e lumenjve (Gjanica, Ishmi, Erzeni etj.) nga sasia e mbetjeve të lëngshme (urbane dhe industriale) të shkarkuara në to tejkalon aftësinë e tyre përpunuese/pastruese. Vetëm në lumin Gjanica në Fier janë shkarkuar rreth 30-35 milionë m3 mbetje të lëngëta në vit dhe janë hedhur rreth 300 000 tonë mbetje të ngurta në vit në brigjet e tij . Lumenj të tjerë janë mbishfrytëzuar për materialet inerte, me pasojë dëmtimin e shtratit, zonave ripariane, zvogëlimin e rrjedhës përtej asaj të lejuar biologjike etj. Teorikisht, sipas OKB-së, Shqipëria ka burime të bollshme uji (13 000$m^3$ ujë/vit për çdo banor), më shumë se Italia (2 900 $m^3$/vit/person), apo Greqia (6 500$m^3$/vit/person ). Megjithatë, furnizimi me ujë mungon në shumë vendbanime, në disa të tjera nuk ka më tepër se 2 orë ujë në ditë, ndërkohë që Shqipëria rrezikon të mos jetë në gjendje t'i përdorë burimet ujore për shkak të përkeqësimit të gjendjes së tyre.

Por, nëse uji do të menaxhohej në mënyrë të integruar, nuk do të përjetonim dilema të jetëgjatësisë së burimeve ujore, të cilësisë së ujit të pijshëm, të zgjedhjes së shishes




Burimi: Harta e përgatitur nga Co-PLAN, 2014 - Të dhëna nga Ministria e Mjedisit.

Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2015 - Tokë e përmbytur në Kuçovë.







Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2015 - Pamje nga gjendja e burimeve ujore në qytetin e Beratit.

plastike përkundrejt ujit nga sistemi i ujësjellësit publik, të vendimmarrjes nëse do të ndërtojmë hidrocentrale apo fuqizojmë turizmin etj. Menaxhimi i integruar i burimeve ujore mbështetet në parimin se burimet ujore janë një pjesë përbërëse e ekosistemit, një burim natyror dhe një e mirë sociale dhe ekonomike . Kjo i jep përkujdesjes për burimin ujor, avantazh ndaj shfrytëzimit të tij. Një sjellje e tillë na ndihmon të fuqizojmë aftësinë për të qenë "resilient" – mbijetues, të adaptueshëm, vetëripërtëritës.

Së fundi, një menaxhim realisht i integruar do të ndikonte edhe në ristrukturimin institucional e të qeverisjes; do të mundësonte decentralizimin në nivel rajoni. Ministritë do të bashkëpunonin dhe një qeverisje rajonale do të koordinonte politikat e tyre në nivel territori e baseni ujor. Do të ishte praktika e menaxhimit të burimeve ujore që do të nxiste rajonalizimin. Fakti që deri më sot nuk ia ka arritur, tregon se nuk kemi hyre ende në cikle të menaxhimit të integruar të burimeve ujore.

# PO SIKUR LINJA HEKURUDHORE të ishte Një Ndër Mënyrat Kryesore të Transportit?

**Hekurudha dhe lëvizja mbi shina luan një rol thelbësor në funksionimin e qyteteve Evropiane, në nivel mobiliteti pasagjerësh dhe mallrash me karakteristikë dalluese transportin masiv dhe distancat e gjata të linjave me treguesit kryesorë të transportit në ton dhe ton/km. Kjo vlen dhe në rastin e vendeve me reliev malor: Zvicra, me mbi 60% të territorit me karakter malor dhe një popullësi rreth 8.2 milionë banorë, ofron një nga shembujt e suksesshëm të sistemit hekurudhor, krijuar në vitin 1902, me afërsisht 1.2 milionë pasagjerë dhe 210,000 tonë mallra të transportuara çdo ditë .**






Burimi: (Lart) Arkiva Co-PLAN - Lushnje. (Poshtë) Swiss Federal Railways në www.sbb.ch/en aksesuar në Maj 2015.


Sistemi hekurudhor shqiptar nuk shtrihet në të gjithë territorin e vendit. E megjithatë, ky sistem ka arritur në momentet më të mira të tij, të transportojë 13 milionë banorë/vit, 8.5 milionë tonë/vit , ndërsa sot, në të gjithë vendin qarkullojnë 329,000 banorë në vit. Të dhëna nga ekspertë të Drejtorisë së Përgjithshme e Hekurudhës Shqiptare, nënvizojnë se nga të gjitha llojet e transporteve, ai hekurudhor në kushte funksioni dhe efiçence të plotë, konsiderohet si më me leverdi. Kostoja e transportit të mallrave me hekurudhë në Shqipëri është vërtetuar të jetë 2,7-3 herë më e vogël se në transportin automobilistik dhe 1,7 herë më e vogël se në atë detar. Por në Shqipëri nuk është ky rasti: me 730 km linjë hekurudhore dhe me rreth 45 stacione, hekurudha thuajse 100-vjeçare mbetet ndër modalitetet e vetme të transportit (infrastruktura) e që nuk ka përfituar investime në këto 25 vite. A do të justifikonte hekurudha shqiptare investimin që duhet për ta rimëkëmbur atë? Sipas një vlerësimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave, do të duhej një investim në vlerën 600 milionë Euro. Studimet e Bankës Botërore tregojnë për mungesë të fizibilitetit, në përzgjedhjen e hekurudhës si modalitet thelbësor në transportin publik Shqiptar. Strategjia sektoriale e transportit 2008-2013 ka përfunduar prej dy vitesh. Duke u bazuar në faktet e mësipërme si dhe në rëndësinë që i jep Bashkimi Evropian logjistikës, për transportin hekurudhor do duhet të krijohet një strategji e qartë për 5 vitet e ardhshme, gjë që nuk është bërë në këto 25 vite.

Sot, në Shqipëri, lëvizin rreth 445,952 makina në vit dhe nëse bëjmë një përllogaritje të thjeshtë, rezulton se çlirohet rreth 90ton/km (model Mercedes Benz, Viti i prodhimit 2011, 2.2). Relievi i vështirë kërkon pajisjen me rrjete rrugore efiçente e të shpejta, që u shërbejnë jo vetëm nevojave shqiptare, por dhe atyre rajonale.

Si do të ndikonte realisht hekurudha shqiptare në fuqizimin e rolit të vendit në logjistikën e rajonit? A do të ndihmonte që cilësia e ajrit të përmirësohej, të ulej numri i aksidetenve, të uleshin kostot e transportit, të rritej shpejtësia e lëvizjes dhe cilësia e transportit? Po me ekosistemet natyrore çfarë do të ndodhte? Përgjigjet për këto pyetje e më shumë kërkojnë studime serioze e prioritet.

Burimi: (Djathtas) Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.
(Majtas) South East Europe Observatory.




**RRUGA**

Në një kilometër, me një litër transporton 50 ton mall.

**DET**

Në një kilometër, me një litër transorton 127 ton mall.

**HEKURUDHA**

Në një kilometër, me një litër transporton 97 ton mall.

**AVION**

Në një kilometër, me një litër transporton 5 ton mall.

Burimi: (Grafiku) Libro Bianco sul Futuro dei Trasporti.

# PO SIKUR TË GJITHË T'I PAGUANIM TAKSAT?

**Taksimi është i vetmi instrument i cili mbështet autoritetet publike, që jo vetëm të grumbullojnë të ardhura për ofrimin e shërbimeve publike, por gjithashtu shërben si një mjet për të orientuar zhvillimin. Megjithatë, në një situate ku sistemi i taksimit mbetet ende i pa mirëreformuar, shpesh dhe pre e abuzimeve, qytetarët humbasin besimin në pagimin e taksave, sikundër dhe dëshirën për t'i paguar në mënyrë të rregullt ato.**




**Një ndër burimet e qënësishme për qeveritë vendore është e ardhura prej taksës së pasurisë. Objekti i Taksës së pasurisë në Shqipëri janë ndërtesat dhe toka bujqësore dhe baza e llogaritjes është sipërfaqja bruto e këtyre pronave. Megjithatë, të ardhurat e gjeneruara nga kjo taksë janë fare të papërfillshme.**

Një ndër burimet e qënësishme për qeveritë vendore është e ardhura prej taksës së pasurisë. Taksa e pasurisë në Shqipëri është fare e thjeshtë, objekt i saj janë ndërtesat dhe toka bujqësore dhe baza e llogaritjes është sipërfaqja bruto e këtyre pronave. Megjithatë, të ardhurat e gjeneruara nga kjo taksë janë fare të papërfillshme. Sipas një studimi të FMN-së, në vitin 2014, taksa e pasurisë përbënte vetëm 0,13 % të PBB-së në vend, vlera këto tepër modeste krahasuar me potencialin për të gjeneruar të ardhura, që mbart kjo taksë.


Në fakt janë një sërë faktorësh të cilët ndikojnë në nivelin e ulët të grumbullimit dhe efektivitetin e taksës së pasurisë në Shqipëri. E aplikuar vetëm mbi ndërtesat dhe tokat bujqësore, taksa e pasurisë dështon të marrë në konsideratë, potencialin e madh të tokës urbane, duke e bërë këtë të fundit pre dhe objekt të spekulimeve të shumta në tregun e pasurive të paluajtshme. Nivelet e taksës në Shqipëri janë relativisht të ulëta dhe rregullohen duke marrë parasysh vetëm vitin e ndërtimit apo llojin e kategorisë së tokave agrikulturore. Në mungesë të kapaciteteve administrative, bazës së saktë të të dhënave mbi pronat, taksa arrin të kapë një vlerë fare të vogël të kategorisë familjarë, të cilët përbëjnë dhe numrin më të madh të përdoruesve të pronave në Shqipëri. Së fundmi, me një bazë sipërfaqen bruto të pasurisë së paluajtshme, taksa e pasurisë jo vetëm nuk reflekton vlerën e vërtetë të përmirësimeve të bëra në pronë, por gjeneron shumë pak të ardhura për njësitë vendore me qëllim ofrimin e më shumë shërbimeve.

Megjithatë, edhe pse në këto kushte, në vlera fare modeste, niveli i grumbullimit të taksës së pasurisë për qytetin e Tiranës është vetëm 731milion lekë , në një moment kur potenciali që mundet të grumbullojë kjo taksë kap vlerën prej 2.164 miliard lekë apo 33.8% më shumë se normal aktuale të grumbullimit. Kostot e një performance të dobët në grumbullimin e të ardhurave nga taksa e pasurisë, përkthehen drejtpërdrejtë në më pak të ardhura për frymë për qytetarët, në më pak shërbime të ofruara dhe rrjedhimisht në vlera më të ulëta të pronave të tyre.

Për këtë arsye qeveria ka vendosur së fundmi kalimin nga taksa e pasurisë mbi bazë sipërfaqen në taksën e pasurisë mbi bazë vlerën e pronës. Ndonëse, në dukje një proces më i komplikuar, i cili do të kërkojë mbledhjen e saktë të të dhënave dhe reformim të tregut të pasurive të paluajtshme, avantazhet e kalimit drejt kësaj forme taksimi janë të qarta. Në terma bazik ekonomik, kalimi drejt kësaj forme taksimi, e bën taksën e pasurisë ekonomikisht më efiçente, duke grumbulluar më shumë të ardhura, nga ato prona, vlera e së cilave rritet për shkak të më shumë shërbimeve. Për më tepër, duke qënë se taksa e pasurisë do të mbetet një taksë vendore, vlera e së cilës kapitalizohet me nivelin dhe cilësinë e shërbimeve, ajo kthehet në një taksë-përfituese, duke u bërë më lehtësisht e kuptueshme nga taksapaguesit. Së fundmi, aplikimi i taksës së pasurisë mbi bazë vlerën e pronës, e bën atë një taksë më të drejtë, për sa kohë vlera e pronës lidhet ngushtë dhe me aftësinë paguese, më shumë sesa me sipërfaqen bruto të një prone.


Kalimi nga një taksë me bazë sipërfaqen në një taksë bazuar në vlerën e pronës, veç kompleksiteteve në aplikimin e saj, është një nga hapat kyç për tu ndërmarrë nga qeveria Shqiptare. Kjo jo vetëm do të ndihmojë në uljen e pabarazive në tregun e pasurive të paluajtshme, por do të ndihmojë njësitë e reja vendore të ofrojnë më shumë shërbime për qytetarët dhe ti orientojë ato drejt një zhvillimi të qëndrueshëm të qyteteve tona.

Burimi: Arkiva Co-PLAN.




Shëmbulli i mëposhtëm ilustron aplikimin dhe vlerën e taksës, në rastin e aplikimit të saj në dy forma: në bazë sipërfaqen e pronës dhe mbi bazë vlerën e tregut.

**Rasti A:** Një apartament me sipërfaqe 65 $m^2$ në qytetin e Tiranës, paguan një taksë pasurie prej 931 Lekë/Vit.
**Rasti B:** Shembulli më poshtë tregon se si ndryshon taksa e pasurisë në rastin kur aplikohet në bazë vlerën e pronës, për një apartament tip me një sipërfaqe 65 $m^2$ në qytetin e Tiranës, në një pallat 10 katësh dhe sipërfaqe gjurme 325 $m^2$.




* Rasti i një apartamenti në Tiranë, ku të gjitha variablat janë të pandryshueshme.

# PO SIKUR Ligji për Administrimin e Bashkëpronësisë në Ndërtesat e Banimit të FUNKSIONONTE?

Zhvillimet social-ekonomike dhe politike që kanë ndodhur në vend kanë lënë gjurmë të dukshme në sektorin e banesave. Deri në vitet 1990, strehimi dominohej tërësisht nga shteti si furnizuesi, financuesi, ndërtuesi, zotëruesi dhe mirëmbajtësi (thuajse) i vetëm i banesave.

Ndryshimi i realitetit pas vitit 1990 e transformoi sektorin, duke rritur gamën e aktorëve, produkteve dhe marrëdhënieve, përmes (fillimisht) procesit të privatizimit. 98% e stokut u privatizua në thuajse 1 vit. Mirëpo, krahas tregut të lirë duhet të garantohej edhe mirëmbajtja e banesave (veçanërisht stoku ekzistues). Përgjegjësia u transferua nga shteti (ish-ndërmarjet komunale) tek pronarët e banesave. Nën ndikimin e një mentaliteti "shteti bën gjithçka" për pronën e përbashkët, dhe prej vështirësive financiare, në pothuajse 2 dekada prona e përbashkët "banesë" nuk u administrua. Kjo rezultoi në amortizim thuajse tërësor të stokut të banesave të trashëguara nga periudha 1945-1990. Këto përbëjnë sot 50% të ndërtesave për qëllime banimi [338,896 (Instat, 2014) nga 600,000), ndërkohë që 9-10% e stokut të banesave janë jashtë kushteve minimale të banimit . Ndërtesat dallojnë mes tyre sipas vitit të ndërtimit, materialeve e teknologjisë së ndërtimit, cilësisë dhe arkitekturës. Meqenëse mosha e këtij stoku varjon nga 25-70 vjeç, rehabilitimi apo rigjenerimi i tyre përbën një domosdoshmëri.

Deri më sot nuk ka një inventar të plotë të karakteristikave fizike të këtyre ndërtesave. Gjithsesi, duket se ndërtesat janë me çati apo tarracë, parafabrikate betoni, tulla me vrima ose të plota dhe druri. Sipas një studimi të Co-PLAN (2008, në stokun e ndërtesave të banimit në Tiranë rezulton se ndërtesat e suvatuara dhe të pasuvatuara qëndrojnë në raportet 78.1% me 16.9%; ato të termoizoluara janë vetëm 4.9%. Fatkeqësisht, ato të pasuvatuara në shumicën e rasteve përkojnë me parafabrikatët (dominues gjatë viteve '60 –'90të).

Ligji "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit" u miratua në prill 2009. Ai ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve juridike që lindin për shkak të bashkëpronësisë së detyrueshme në ndërtesa. Këto marrëdhënie përfshijnë një sërë aktorësh – qytetarë, bashki, banka, shoqëri administrimi, etj.

Sikur ligji të zbatohej, për çdo ndërtesë shumëfamiljare banimi (apo grup ndërtesash) duhet të ishin themeluar Asambletë e Bashkëpronarëve, me përgjegjësi qytetare e ligjore për administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës. Stoku prej 338,896 banesash (vitet 1945-1990) do të ishte rehabilituar gradualisht, duke rritur jo vetëm cilësinë e banesave me kosto të përballueshme në kohë, por duke ndryshuar imazhin e qytetit në mënyrë të qëndrueshme. Mbi të gjitha, qytetarët do të kuptonin përgjegjësinë e tyre ndaj banesës dhe qytetit, dhe do të punonin për të mirëmbajtur në kohë investimin e tyre.





Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2015.

# FOND I ZHVILLIMIT TË LAGJEVE ?

Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2015.









**Jetueshmëria e një qyteti shpesh matet nga jetueshmëria e lagjeve të tij. Kjo është ajo çka shohin e prekin banorët në të përditshmen e tyre. Madje, kjo cilësi e hapësirës rregullon stresin urban dhe edukon brezat me ndjeshmëri urbane. Por a duhet njerëzit vetëm të presin që lagjet e tyre t'i rigjallërojë bashkia? Çfarë mund të bëjnë vetë qytetarët,që fondet e pakta për investime urbane të investohen afër rrugës apo shtëpive të tyre?**

Sikur bashkia të ofronte një skemë "Fondi të Zhvillimit të Lagjeve", kjo do të zgjonte interesin e banorëve për t`i pasur ato. Banorët mund të krijonin grupe komunitare që do të aplikonin për të siguruar fonde për lagjen. Në mënyrë aktive, grupi komunitar do të punonte për te gjeneruar ide, projekte për hapësira publike të gjelbërta, rigjenerim të ndërtesave, rehabilimit energjitik, rrugë më të mira, korsi të biçikletave, qendra komunitare për të rinjtë dhe kulturën e qytetit etj. Lagjet e zymta do të mbusheshin në hapësira të rigjallëruara.

Sikur "Fondi i Zhvillimit të Lagjeve" të ekzistonte, bashkia do të organizonte:
Konkursin e ideve për hapësira të jetueshme: "Qyteti ndërtohet nga njerëzit për njerëzit". Qytetarët proaktivë nuk do të prisnin për ofertat e institucioneve, por do të mprehin kërkesën e tyre për të realizuar hapësirave të jetueshme në qytet. Çdo ide fituese e konkursit, të ideve qytetare/komunitare për hapësira dhe qytete të jetueshme, mund të kthehej në një projekt zbatimi me fonde të bashkisë, e sipas rastit bashkëfinancim komunitar.

Programin konkurues të zhvillimit të lagjeve: Më shumë hapësira dhe infrastruktura publike cilësore, do të ndërtoheshin aty ku komuniteti, do të ishte i gatshëm të hartonte agjendën e zhvillimit të lagjes dhe të tregonte vullnet për bashkëfinancim. Do të zhvillohej ndjenja e pronësisë dhe përgjegjësisë ndaj investimit dhe hapësirës së përbashkët.

# PO SIKUR TË NDODHTE REHABILITIMI ENERGJITIK I STOKUT TË BANIMIT NË TIRANË ?

**Zhvillimet e fundit në sektorin energjitik kanë risjellë në fokus konsumin e lartë dhe performancën e ulët energjitike të stokut të banesave në vendin tonë. Kjo e fundit është edhe më e dukshme në rreth 50% të stokut, që sipas INSTAT 2014 përbëhet nga ndërtesat e banimit të 1945-1990të. Nëse të rehabilituara energjitikisht, vlera e ndërtesave në treg do të rritej. Për më shumë, ndërsa kosto e energjisë elektrike apo e burimeve të tjera energjitike rritet, në 30-35 vitet e ardhshme banorët gjithsesi do të vazhdonin të kursenin në faturën e energjisë.**


Burimi: Arkiva Co-PLAN. Lagja "8 Shkurti", Fier, 2010.



Zhvillimet social-ekonomike dhe politike që kanë ndodhur në vend kanë lënë gjurmë të dukshme në sektorin e banesave. Deri në vitet 1990, strehimi dominohej tërësisht nga shteti si furnizuesi, financuesi, ndërtuesi, zotëruesi dhe mirëmbajtësi (thuajse) i vetëm i banesave.

Ndryshimi i realitetit pas vitit 1990-të e transformoi sektorin, duke rritur gamën e aktorëve, produkteve dhe marrëdhënieve, përmes (fillimisht) procesit të privatizimit 98% e stokut u privatizua në thuajse 1 vit. Mirëpo, krahas tregut të lirë duhet të garantohej edhe mirëmbajtja e banesave (veçanërisht stoku ekzistues). Përgjegjësia u transferua nga shteti (ish-ndërmarjet komunale) te pronarët e banesave. Nën ndikimin e një mentaliteti "shteti bën gjithçka" për pronën e përbashkët dhe prej vështirësive financiare, në pothuajse 2 dekada prona e përbashkët "banesë" nuk u administrua. Kjo rezultoi në amortizim thuajse tërësor të stokut të banesave të trashëguara nga periudha 1945-1990. Këto përbëjnë sot 50% të ndërtesave për qëllime banimi [338,896 (Instat, 2014) nga 600,000), ndërkohë që 9-10% e stokut të banesave janë jashtë kushteve minimale të banimit . Ndërtesat dallojnë mes tyre sipas vitit të ndërtimit, materialeve e teknologjisë së ndërtimit, cilësisë dhe arkitekturës. Meqenëse mosha e këtij stoku varjon nga 25-70 vjeç, rehabilitimi apo rigjenerimi i tyre përbën një domosdoshmëri.

Deri më sot nuk ka një inventar të plotë të karakteristikave fizike të këtyre ndërtesave. Gjithsesi, duket se ndërtesat janë me çati apo tarracë, parafabrikate betoni, tulla me vrima ose të plota





Burimi: Arkiva Co-PLAN - Lagja "8 Shkurti", Fier, 2012.

dhe druri. Sipas një studimi të Co-PLAN (2008, në stokun e ndërtesave të banimit në Tiranë rezulton se ndërtesat e suvatuara dhe të pasuvatuara qëndrojnë në raportet 78.1% me 16.9%; ato të termoizoluara janë vetëm 4.9%. Fatkeqësisht, ato të pasuvatuara në shumicën e rasteve përkojnë me parafabrikatët (dominues gjatë viteve 60–90).

Ligji "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit" u miratua në prill 2009. Ai ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve juridike që lindin për shkak të bashkëpronësisë së detyrueshme në ndërtesa. Këto marrëdhënie përfshijnë një sërë aktorësh qytetarë, bashki, banka, shoqëri administrimi etj.

Sikur ligji të zbatohej, për çdo ndërtesë shumëfamiljare banimi (apo grup ndërtesash) duhet të ishin themeluar Asambletë e Bashkëpronarëve, me përgjegjësi qytetare e ligjore për administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës. Stoku prej 338,896 banesash (vitet 1945-1990) do të ishte rehabilituar gradualisht, duke rritur jo vetëm cilësinë e banesave me kosto të përballueshme në kohë, por duke ndryshuar imazhin e qytetit në mënyrë të qëndrueshme. Mbi të gjitha, qytetarët do të kuptonin përgjegjësinë e tyre ndaj banesës dhe qytetit, do të punonin për të mirëmbajtur në kohë investimin e tyre.